



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 18 nëntor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi : Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimet
lidhur me Rishikimin e Ardhshëm për Paraburgimin e z. Shala**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 41(10) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 9(5)(a) dhe (6) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 10 nëntor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit (“Vendimi i Tretë i Paraburgimit”)² për Pjetër Shalën (“z. Shala”). Në atë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi Mbrojtjen e z. Shala (“Mbrojtjen”), që, nëse dëshironte, të paraqiste parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit ose më 17 dhjetor 2021, me përgjigje dhe kundërpërgjigje sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores, ose më 5 Janar 2022, në përgjigje të parashtrimeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”).³
2. Më 15 nëntor 2021, gjatë konferencës së fundit për ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se afatet e sipërpërmendura përkojnë me periudhën e pushimeve vjetore të gjykatës dhe pyeti Mbrojtjen nëse kjo e fundit dëshironte të kërkonte një ndryshim të afatit në mënyrë që të bënte parashtrimet pas periudhës së pushimit vjetor të gjykatës, ose në rast se synonte të apelonte Vendimin e Tretë të Paraburgimit, pas vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit.⁴
3. Më 16 Nëntor 2021, Mbrojtja kërkoi një ndryshim të afatit në mënyrë që të paraqiste parashtrimet e saj në përgjigje të parashtrimeve të ZPS, brenda datës 21 janar

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 Shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-04, F00105, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës*, 10 nëntor 2021, konfidencial, para. 47(a). Versioni i redaktuar publik u shpall në të njëjtën ditë, F00105/RED.

³ Vendimi i Tretë i Paraburgimit, para. 47(b)-(c).

⁴ KSC-BC-2020-04, Transkript i seancës, 15 nëntor 2021, publik, f. 125, rreshti 6 deri më f. 126, rreshti 6.

2021 ("Kërkesa").⁵ Sipas Mbrojtjes, ekzistojnë arsye të vlefshme për ndryshimin e kërkuar si pasojë e ndeshjes së afateve dhe detyrimeve procedurale me të cilat ajo po përballet në këtë periudhë.⁶ Mbrojtja konfirmon më tej se z. Shala heq dorë nga e drejta e tij për rishikimin e vendimit të paraburgimit çdo dy muaj.⁷

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores parashikon se deri sa aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirim, pas kalimit të dy (2) muajve nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Paneli që merret me çështjen shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtjen në paraburgim dhe nxjerr vendimin për vazhdimin ose përfundimin e paraburgimit.

5. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të zgjasë ose të shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara prej Rregullores ose prej Panelit.

6. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret pa u dhënë atyre mundësinë për të shprehur mendimin.

III. DISKUTIMI

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr parasysh parashtrimin e Mbrojtjes se në periudhën në vazhdim Mbrojtja do të përballet me mbivendosje afatesh dhe detyrime procedurale⁸ dhe gjykon se ka arsye të vlefshme që përlijin kërkesën për zgjatjen e

⁵ KSC-BC-2020-04, F00108, Mbrojtja e z. Shala, *Kërkesë e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Parashtrimet e saj lidhur me Rishikimin e Paraburgimit të z. Shala*, 16 nëntor 2021, publik.

⁶ Kërkesa, para. 3.

⁷ Kërkesa, para. 3.

⁸ Kërkesa, para. 3

afatit. Në këtë aspekt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se z. Shala ka hequr dorë nga e drejta e tij për rishikimin e paraburgimit para kalimit të afatit dy mujor të parashikuar në nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores.⁹

8. Duke pasur parasysh ndryshimin e autorizuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se duhet të shtyhet edhe afati për paraqitjen e parashtrimeve të ZPS-së. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se ky ndryshim afati para marrjes së përgjigjes ndaj Kërkesës, nuk paragjykon pozicionin e ZPS-së.

IV. VENDIM

9. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

(a) **MIRATON** Kërkesën dhe **URDHËRON** Mbrojtjen që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **ditën e premte, 17 dhjetor 2021**, me përgjigjen pasuese të ZPS-së jo më vonë se **ditën e martë, 11 janar 2022**, dhe kundërpërgjigjen e Mbrojtjes jo më vonë se **ditën e premte, 21 janar 2022**; dhe

(b) **URDHËRON** ZPS-në që në rast se z. Shala vendos të mos paraqesë parashtrime në afatin e sipërpërmendur, të paraqesë parashtrime në rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Shala jo më vonë se **ditën e martë, 11 janar 2022**, dhe z. Shala, nëse ai dëshiron, të paraqesë parashtrimet e tij jo më vonë se **ditën e premte, 21 janar 2022**.

⁹ Kërkesa, para. 3.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 18 nëntor 2021

Në Hagë, Holandë.